

V E N D I M
Nr.43, datë 14.2.1994

**PËR DETYRIMIN E PERSONAVE FIZIKË E JURIDIKË PËR T'U PAJISUR ME ARKA
REGJISTRUESE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe në zbatim të neneve 9 e 10 të ligjit nr.7758, datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Gjithë personat fizikë e juridikë që shesin mallra e prodhime ose kryejnë punime e shërbime të ndryshme në lokale e njësi të tjera të përhershme të hapura për publikun, detyrohen të pajisen me arka regjistruese.

2. Pajisja e subjekteve me arka regjistruese do të bëhet me përparësi sipas kësaj radhe:

a) Lokalet e ushqimit social, si restorante, pijetore, hotele, qendra turistike të ndryshme, bufe e të tjera të kësaj natyre.

b) Lokalet që tregtojnë mallra të ndryshme industriale, ushqimore, fruta, perime e të tjera të kësaj natyre.

c) Lokalet e shërbimeve publike e artizanale të të gjitha llojeve.

3. Sigurimi i arkave regjistruese do të bëhet nga shteti dhe është monopol i tij. Ministria e Financave, në përputhje me nevojat për arka regjistruese, merr masat për sigurimin e tyre.

4. Në kushtet e mosplotësimit të njëhershëm të nevojave me arka regjistruese, drejtoria e tatimeve në Ministrinë e Financave, së bashku me degët e saj në rrethe, ka autoritetin të përcaktojë sipas këtij kriteri radhën e pajisjes së subjekteve me to, duke respektuar përparësitë e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.

5. Subjektet që do të pajisen me arka regjistruese, detyrohen që t'u lëshojnë individëve të veçantë kupona tatimore për shitjen e sendeve dhe kryerjen epunimeve a shërbimeve për përdorim vetjak. Moslëshimi i kuponave përbën kundërvajtje administrative sipas ligjit nr.7758, datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet".

6. Montimi i arkave regjistruese, kontrolli dhe riparimi ityre bëhen sipas udhëzimit të miratuar nga ministri i Financave.

Subjekti i pajisur me arkë regjistruese, në rast defekti të saj, detyrohet të njoftojë menjëherë degën e tatimeve të rrethit brenda 24 orëve nga momenti i konstatimit.

7. Arkat regjistruese do t'u shiten tregtarëve kundrejt çmimit që përfshin çmimin e blerjes, koston e instalimit dhe koston e mirëmbajtjes për vitin e parë.

Afati maksimal për arkëtimin në buxhet të vleftës të arkave regjistruese nga subjektet do të jetë 2 muaj, duke filluar nga data e montimit të arkës regjistruese. Për mosderdhjen e detyrimit sipas këtij afati, organet tatimore zbatojnë dispozitat e ligjit nr.7681, datë 9.3.1993 "Për administrimin e tatimeve dhe taksave".

Kostoja e mirëmbajtjes për vitet e tjera do të paguhet nga subjektet e pajisura me arka regjistruese çdo vit sipas shumës dhe afateve që përcaktohen nga Ministria e Financave në kontratën e lidhur me furnizuesin për këtë qëllim.

8. Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi